Temperatura, të rriturve zakonisht matet nga goja apo nënsqetulla. Fëmijëve është mirë që temperatura t'u matet nga mbrapa (zorra e trashë) ose nënsqetulla. Në qoftëse temperatura matet nga mbrapa maja e matësit duhet të lyhet me ndonjë krem të thjeshtë të yndyrshëm dhe me kujdes vihet maja e matësit mbrapa. Është mirë që temperatura të matet gjithmonë në një vend të njëjtë për shkak se rezultatet e matjes në vendet tjera janë të ndryshme.

### Matësi digjital

- Para matjes shiko njëherë se matësi funksionon dhe se është i gatshëm për matje.

### Kur matni temperaturën:

- Nga goja, mbaje gojën mbyllur për 5 minuta dhe vendose majen e matësit nën gjuhë dhe mbylle gojën. Mbaje matësin në gojë derisa sinjalizon, pastaj shiqo rezultatit.
- Nga nënsqetulla, mbaje krahun e dorës mbështet për trupi për 5 minuta. Pastaj vendose majen e matësit nënsqetull, e mban shpatullen shtrengueshëm përderisa matësi sinjalizon, pastaj shiko rezultatit.
- Nga mbrapa (zorra e trashë), vendose me kujdes matësin, prit derisa sinjalizon pastaj shiko rezultatit.

### Matësi i zakonshëm

- Para se të matni temperaturën, shiko se matësi tregon nën 36. Mundeni ta shkudenti matësin me qëllim që të zbritet treguesi nën këtë shkallë.
- Të rriturve u vendoset nënsqetull të terur nga ana e hollë e matësit.
- Mos lëviz pa nevojë gjatë matjes së temperaturës, sepse matësi mund të thyhet.
- Matësin mund ta heqni pas 10 minutave nga nënsqetulla dhe ta shikoni rezultatit. Fëmijut që i matet temperatura nga mbrapa rezultatit mund ta shikoni pas 4 minutave.

---

35 - 37°C	= Temperaturë normale
37 - 38°C	= Temperaturë pak e ngritur
38 - 39°C	= Temperaturë e ngritur
Mbi 39°C	= Temperaturë e lart

---

**Pyete infermjerin për udhëzime tjera!**

# TERVEYSVAIVAIN

## Shërimi i temperaturës

### IRRITURI

- I rrituri që ka temperaturë nuk ka nevojë menjëherë shërim prej mjekut.
- Në qoftë se temperatura ngritet mbi 38°C, në barnatore mund të merrni barna si psh. (parasetamol, acidacetiliksalicinik), në barnatore mundë të ketë gjithëashtu edhe preparate tjera të ndryshme.
- Pi shumë (ujë, qaj) dhe pusho.

### Kontakto mjekun:

- Në qoftë se edhe pas tri dite keni temperaturë të ngritur.
- Në qoftë se juve ju çfaqen simptome tjera si psh. Dhembje të veshëve, kollitje të forta, dhembje të mëdha koke.

### FEMIJET

- Më të vegjël se 1,5 fëmijët me temperaturë 37,5 - 38,5°C mundet me qenë normale.
- Fëmijës më të rritur, temperatura normale është 36 - 38°C.

### Fëmijun që ka temperaturë të lartë dergoje te mjeku në qoftëse:

- temperatura e tij është 40°C dhe shihet kjart se fëmija është në gjendje të keqe
- fëmija është më vogël se tre muaj
- fëmija ka temperaturë të ngritur mbi tri ditë
- fëmija është në gjendje të dobët, i lodhur, pa apetit për ushqim, ka dhembje
- fëmija ankohet në stomak dhe në urinë
- fëmija ka gërqe

Prindërit e fëmijëve në përgjithësi e vërejnë se a ka fëmija temperaturë të zakonshme nga lojrat ditore apo fëmija është i sëmuar.

### Shërimi në shtëpi i fëmijës që ka temperaturë të ngritur

- Zvoglo rrobat dhe mbulesat, jepi shumë lëngje dhe ujë.
- Fresko dhomat, kështu që temperatura e trupit do të bjer.
- Kujdesu që fëmija të pushoj në qetësi.
- Në qoftë se fëmija ka temperaturë mbi 38°C, fëmijës jepi supisutor kundër temperaturës nga zorra e trashë, mirëpo duke ju përmbajtur udhëzimeve së dhënjes me kujdes.

# TERVEYSVAIN

## Udhëzime për shërim të gripit

Gripi vjen zakonisht nga virusi që shpesh infektimi është shumë i shpejt. Mund të zgjatë deri një javë. Simptomët fillojnë të manifestohen shpejt:

- zakonisht temperaturë nën 38,5°C
- lodhje, dobësi
- dhembje muskujve
- dhembje koke
- kollitje, shkuarje nga hunda

### Shërimi:

- pusho dhe fresko dhomat
- pi shumë (ujë,qaj) veçanërisht në qoftëse keni temperaturë të ngritur
- merr barna të nevojshme për zvoglim të temperaturës dhe barna për zvoglim të dhembjeve
- për kollë simbas nevojës mund të përdorni barna
- frymëmarrja në avull të ngrohtë i lehtëson shumë kollitjen fëmijut
- barnat mund t'i merrni në barnatore pa recept
- fëmijut jepi barna për kollë vetëm në qoftë se fëmiju ka kollitje të gjata dhe të thata.



# TERVEYSVAIVAIN

## Shërimi nga morrat e kokës

Morrat depërtojnë ose shumohen në flokë. Ata zhvillohen në vezë të vogla të rrumbullakta domethën thërija që janë të ngjitura për rrënje të flokëve. Nga vezët e morrave, thërijat, mbrenda dy jave zhvillohen në morra të rinjë.

Morrat depërtojnë ose ngjiten drejtpërdrejt nga personi tjetër, nga mjetet personale (si p.sh. krehërve të flokëve) dhe rrobave të ndryshme (si p.sh. kapelave).

### Simptomët:


Kruarje të vazhdueshme, nganjëherë të skuqur të lëkurës së kokës dhe keni thërija në flokë. Zakonisht morrat gjenden mbrapa qafës dhe mbrapa veshëve.

### Shërimi:

Morrat mund t'i heqesh me shampoon kundër morrave, i cili shampoon në vete përmban hexicid apo pyretrin. Pastroj flokët plotësisht me këtë shampoon së paku katër minuta, i shpërlan mirë dhe flokët e pastërta krihi me kujdes me krahër të shpeshë, që me atë kryesisht mundë të hiqen të gjitha thërijat ose vezët e morrave. Përsërite të njëjtën gjë pas një dite sipas nevojë. Pas një jave shërimi në këtë mënyrë, shko në kontrollim te mjeku.

Krehërit, brushat apo gjërat tjera, që mund të ken morra apo thërija në to, dezinfektoni me shampoon kundër morrave. Pastroj rrobat, peshqirët dhe rrobat sezonore dhe hekurosi me hekur të nxehtë.

Në qoftë se një anëtar në familje ka morra, sigurisht edhe të tjerëve do t'u ngjiten ata, sepse morrat përhapen shumë shpejt. Kjo domethën se gjithë familja njëkohësisht duhet të shërohet.



# TERVEYSVAIN

## Shërimi i zgjebës ose scabiesit

Zgjeben ose kruarjen e shkakëtojnë parazitët të cilët gjenden dhe shumohen mbrenda në lëkurë. Kruarja është simptom i parë. Në lëkurë shihen shenja dhe puçrra të ndryshme.

Para fillimit të përdorimit të barit merr dush. Pastroje lëkuren me kujdes me sapun mirëpo iku fërkimeve të forta. Pasandej me kujdes tere lëkurën e trupit.

Me ilaçin që në vete përmban heksicide, të lyhet e gjithë sipërfaqja e lëkurës së trupit prej qafës e deri te gishtrinjët e këmbes. Vetëm fëtyra dhe lëkura e kokës mbesin të pa lyera. Sasia e barit shërues për një person të rritur është afer 200 ml, për fëmijë të moshës shkollore 100 ml.

Shumë me rëndësi është që me këtë barë t'i lyesh duart dhe kyqin e duarve sepse në këto vende të lëkurës gjenden pjesa më e madhe e këtyre parazitëve të zgjebës.

**Me këtë ilaç nuk guxon ta lyesh fëtyren!** Meshkujt duhet të jenë të kujdesëshëm në lëkurën e testiseve, sepse prej ilaqeve me efekt të fortë ato mundë të pezmatohen. Për ta ruajtur ilaqin që të mos fshihet nga lëkura gjatë natës vishu me pixhame me mangë të gjata. Gjatë kohës së shërimit është mirë të keni të mbathura qorapë të pambukëta dhe në duar dorëza të pambukëta. Në qoftë se ndër kohë heq dorëzat nga duart duhet përsëri ti lyesh duart me ilaç.

Pas 24 orëve (fëmijëve nën 3 vjet, pas 6 orëve), zhveshi rrobat mbrojtëse të veshura, dhe pastroje ilaqin nga sipërfaqja e lëkurës me kujdes.

Në qoftë se vetëm njërit prej anëtarve të familjes i janë manifestuar këto simptome në lëkurë, duhet që të gjithë anëtarët e tjerë të familjes të shrohen **përnjëherë**. Për atë arsye dihet që këta parazit të zgjebes janë të fshehur në lëkuren e secilit. Për shërim të fëmijës më të vogël se tri vjet duhet të konsulltoheni me mjekun.

Parazitët të cilët janë në rrobat vjetore apo në rrobat tjera në banes janë te zhdukshëm. Për këtë mjafton të pastrohen çarçafët, këllëfet e jastëkëve, nënkëmishat dhe brekët ose pixhamet. Gjatë kohës së shërimit duhet që çarçafët dhe mbulesat e jastëkëve të vihen të pastërta, të cilat në ditën e nesërme duhet të ndrohen prap në të pastërta. Dyshekët, jastëkët, batanijat, mbulesat tjera dhe gjaketat duhet te ajrosen mirë jashtë banesës.

# TERVEYSVAIVAIN

## Parazitët e zorrëve apo krimbat

Në organizëm të njeriut jetojnë parazit të ndryshëm krimborë, vezë të parazitëve dhe organizma të vegjël. Shpesh bartësit e krimbave nuk kanë simptome. Krimbat mundën gjithëashtu të shkaktojnë dhembje të barkut, mundime, kondicion të përgjithshëm të dobët dhe anemi. Krimbat ngjiten nga të dalurit jashtë, nga perimet e papastruara, dhe nga mishrat dhe peshqit e papjekur mirë.

Mjeku do të jap bari për shërim dhe për largimin e këtyre krimbave. Për shërim të suksesëshëm është e nevojshme të bëhen analiza të reja nga jashtëçitja, nga kjo varet se çfarë llojë krimbi ka shkakëtuar këto simptome. Në këtë mënyrë shihet se a ka ndihmuar bari ose ilaçi i dhënë. Mund të ndodhë që përsëri për një kohë të përdoren barna, dhe të bëhen analiza të reja. Në disa raste duhet të përdoren barna me efekt të fortë, e që duhet të shtrihesh dy ditë në spital. Femrat që janë shtatëzëne, në përgjithësi barnat kundër këtyre parazitëve i marrin vetëm pas lindjes së fëmijes.

# TERVEYSÄVAIN

## Sëmundjet ngjitëse

### SALLMONELLOZA DHE SHIGELLOZA

Sallmonelloza dhe më rrallë shigelloza janë sëmundje të zorrëve që shkaktojnë bakteriet.

#### Simptomët:

- Temperaturë, jashtëçitje, dhembje koke, lodhje. Në shigellozë jashtëçitja mund të është me gjak.

Sëmundja është shumë infektuese. Sëmundja ngjitet nga jashtëçitja. Njëherë në javë bëhet testi nga jashtëçitja me qëllim të largimit të këtyre bakterieve dhe në këtë mënyrë kontrollohen bakteriet të cilat janë shkaktarë të kësaj sëmundje.

Personave, të cilëve në jashtëçitje janë paraqitur bakteriet e sallmonellozes dhe shigellozes, duhet që me kujdes t'u përmbahen udhëzimeve të dhëna.

Gjithë familja duhet të angazhohet në mirëmbajtjen e pastërtis.

#### Preventim nga infektimi

Duart duhet të pastrohen me kujdes pas përdorimit të WC-së gjithëashtu edhe para përdorimit të enëve të ushqimit. Ulësja e WC-së duhet të pastrohet me deterxhent dezinfektues me qëllim të zhdukjes së bakterieve.

Ushqimi duhet të zihet apo piqet mirë, në atë mënyrë që shkaktarët e sëmundjes të zhdukën. Ushqimi i tepërt që mbetet duhet të ruhet në frigorifer (nën + 8°C) apo në vende tjera mjaft të ftohta. Bakteriet nuk shumohen në të ftohtë. Pemët dhe perimet duhet të lahen mirë para përdorimit.

#### Përkujdesjet tjera

Sikurse punëdhënsit gjithëashtu edhe zyrtarët për kujdesjen shëndetësore duhet të dinë për personat të cilët lëngojnë nga sëmundja sallmonellozes dhe shigellozes e që shkaktarë janë bakteriet nga jashtëçitja. Personi i tillë nuk mund të marr pjesë në përdorimin e gjësendeve ushqimore. Për vazhdim të punës zgjedhin vetë zyrtarët në secilin rast veç e veç. Fëmijët mund të shkojnë në qerdhe ditore vetëm atëherë kur nuk kanë manifestim simptomesh. Sa i përket higjienës së duarve dhe higjienës së ushqimit duhet kushtohet kujdesje e veçantë.

Pyet në qendër shëndetësore, infermijerin apo mjekun për udhëzime tjera.

# TERVEYSVAIVAIN

## Shërimi i kapsit

Ushqehu rregullisht dhe siguro kohë të mjaftueshme për këtë. Është gjithëashtu me rëndësi të pish mjaft dhe të merrësh me edukatë fizike.

- Ngrëni materie ushqyese që në brendësi përmbajnë fibër të patretshme, siç janë kokrrat e drithërave, perimet, pemët, manaferrat, arra, laithia etj.
- Perimet sa vijojnë janë të mira: lakrat, domatet, trangulli sallata, patatja, fasulet dhe karrotat.
- Nga prodhimet e qumështit ju propozojmë kos, dhe jogurta të ndryshëm.
- Nga prodhimet e drithërave ju propozojmë: bukën e vrugët, makarona të vrugët, puro nga kokrrat e plota misri, puro orizi.
- Mishi, peshku, edhe organet e brendëshme duhet të jen pak të yndyrshme, vezët dhe suxhuku gjithëashtu janë të mira.
- Pi nga dy gota ujë apo lëngje të lehta, mes aterive.
- Ikë nga të fërguarit e patateve, makaronave, buka e bardhë, burekët e mbushur me mish, nga mishrat e fërguara të yndyrshëm, ëmbëlsirat, çaji, sheqeri, dhe nga çokollatat.
- Ecëni, vraponi, ngjituni në porta dhe ushtroni për çdo ditë. Ushtroni ndonjë sport së paku dy herë në javë.

Në qoftë se edhe mbas udhëzimeve të dhëna me lart vërehet se ende vuani nga kapsi, vizito mjekun ose infermierin, ata sipas nevojës do të japin këshilla dhe barna për shërim të kapsit.

# TERVEYSVAIVAIN

## Sëmundjet ngjitëse

### SHËRIMI I SHKURJES SË BARKUT

Shpesh sëmundja e shkuarjes së barkut është e shkaktuarë nga viruset apo bakteret. Në atë mundë të paraqiten gjithëashtu, vjellje dhe temperaturë. Në sëmundjen e shkurjes së barkut shumë me rëndësi dhe kryesore është përdorimi i lëngjeve. Sepse gjatë kohës së kësaj sëmundje humbin shumë lëngje, dhe është e domosdoshme të kompenzohen me pije të mjaftueshme.

Me këtë sëmundje infektosh shumë lehtë nga jashtëçitja dhe nga të vjellurit, për atë arsye duart duhen të pastrohen shpesh dhe me kujdes.

### Të rriturit

Pi shumë lëngje, ju nuk duhet të ngjini. Në qoftë se shkurja zgjatë më tepër se dy ditë, pyet për udhëzime në qendrën shëndetësore.

### Fëmijët e moshës së çerdhës dhe moshës shkollore

Fëmijëve ju ipen lëngje të shumta, sikur ujë, lëngje, lëng akulloresh etj. Fëmija mundë të hajë gjithëashtu ushqim çfarë ja ka ënda atij. Prodhimet e tharta të qumështit qetësojnë barkun. Në barnatore mundë të bleni fëmijëve Osmosal\* pije për shkurje të barkut. Në qoftë se shkurja zgjatë me tepër se dy ditë, pyet për udhëzime në qendrën shëndetësore.

### Foshnjët

Foshnjeve sëmundja e shkuarjes së barkut është gjithëmonë qështje serioze. Për foshnje lëngjet janë një ndër më të nevojshmet. Qumështi i nënës apo qumështi artificial foshnjes mund t'i ipet normalisht. Si shtesë foshnjes duhet t'i ipet edhe ujë.

Gjendjen shëndetësore të fëmijut përcillenit me kujdes. Kontakto mjekun kur foshnja ka shkuarje të barkut. Në qoftë se fëmiju është i plogësht dhe pa fuqi, dergoje atë te mjeku.

# TERVEYSVAIVAIN

## Sëmundjet ngjitëse

### UDHËZIME BARTËSVE TË HEPATITIT B

Hepatiti B është inflamacion i mëlçisë i shkaktuar nga virusi, i cili përhapet nëpërmjet gjakut dhe spermës. Pjesa më e madhe e të sëmuarve me këtë sëmundje nuk e vërejnë se janë të sëmuar me këtë. Disa nga të sëmuarit (afër 5 %) mbesin bartës të kësaj sëmundje dhe ata mund të infektojnë personin tjetër.

Në test gjakut është vertetur se ju keni hepatitin B. Gjaku me këtë virus të hepatitit B mundë ta infekton personin tjetër. Në qoftëse një sasi mjaft e vogël gjaku vjen në kontakt me plagën e freskët të personit tjetër, përmes lëkurës se gërrithur apo përmes jargëve personi tjetër mundë të sëmuret me hepatit B. Hepatiti B nuk depërton nëpërmes lëkures së padëmtuar.

#### **Vepra kështu, që hepatiti B të mos përhapet:**

- Tregoni se jeni bartës i hepatitit B, kur të vizitoni mjekun, dentistin, në laborator apo infermjerin në sportel.
- Pastrojeni dhe mbulojeni edhe plagët më të vogla me fasho. Leckat e ndytura me gjak duhet të hidhen me kujdes, paketoj në qese plastike para se ti hedhësh në shportën e mbeturinave.
- Mos huazoni tjerëve brushën e dhëmbëve dhe mjetet e rruarjes.
- Për shkak se mundë të infektoheni lehtë në marrëdhënie seksuale përdor gjithëmon prezervativ (kondom), për derisa e dini se partneri nukë është bartës i B hepatitit. Nëse edhe partneri i juaj është bartës i hepatitit B atëherë nuk ka nevojë që të përdoret prezervativ për hepatit B.
- Mos jepni gjak.

#### **Në shtëpi vepra kështu:**

- Rrobat e ndytura me gjak të lahen në makinë larëse në programin e rrobeve të bardha në + 90°C ose të shtihen paraprakisht në solucione dezinfektuese kloride.
- Enët e ushqimit të lahen mirë me deterxhent të zakonshëm.

Bisedo me mjekun apo infermierin për atë se sa shpeshë ju duhet të shkoni në kontrolli-me shëndetësore për shkak virusit të hepatitit B.

Personat, të cilët janë në rrezik të përhershëm për infektim me këtë sëmundje, mund t'i vaksionojm kundër hepatitit B.

# TERVEYSÄVAIN

## Sämundjet ngjitëse

### TUBERKULOZA

Tuberkuloza është sëmundje ngjitëse e shkaktuar nga lloji i mykobakterjes. Në Finlandë tuberkuloza më herët ka qenë sëmundje e përgjithëshme në popullsi, mirëpo tash këtu, rastet janë zvogluar dhe të sëmuarit shërohen. Në përgjithësi lloji i kësaj sëmundje është tuberkulozë në mushkëri. Në organet tjera tuberkuloza manifestohet shumë rrallë.

Shumica nga pacientët mund të dijnë se janë të sëmuar nga tuberkuloza si psh. në kontrollim të mjeku apo nëpërmes kontrolimit fotografik rentgenologjik. Në fillim të sëmundjes nuk vrehen gjithëmon shenja apo simptome të karta: kollitje, pështymë, temperatura të vogla, djersitje natën dhe humbje të kondicionit. Për të vertetur dhe dalluar tuberkulozen nga sëmundjet tjera janë të nevojshme ekzaminimet në spital. Si përfundimtare për vertetim të tuberkulozes merret nga pështyma dhe mostrat tjera nga organizmi.

### Infektimi dhe rreziku nga infektimi

Infektimi përhapet nëpërmes të sëmuarve të kësaj sëmundje, të cilëve pështyma vjen me mikroba basilike të tuberkulozes nga mushkërit. Gati të gjithë pacientet nuk janë infektues. Tuberkuloza nuk ngjitet nëpërmjet librave apo gjëseneve tjera. Vetëm tuberkuloza e mushkërive mund të është infektuese, llojet tjera të sëmundjes së tuberkulozit në përgjithësi nuk janë infektuese.

### Evitimi prej infektimit dhe të infektuarit

Gjithëmonë gjatë kollitjes dhe teshtimës, përpara gojës përdorë faculetë! Mos u kollit në drejtim të personit tjetër! Pështymen e qitur në gotën që përdoret njëherë mbyllet me kapak dhe hudhet ashtu në mbeturina.

### Të afërmit dhe rreziku për sëmundje

Me vertetimin e sëmundjes, nga ju duhet t'i dijmë personat me të cilët keni pas kontakte të shumta. Ju keni mundur të infektoheni nga ata apo ju vetë mund t'i infektoni ata. Është shumë me rëndësi të kontrollohen dhe të shërohen të gjithë ata, të cilët mundësisht kanë mundur të marrin këtë sëmundje.

### Efektiviteti i barit shërues

Bari shërues për tuberkulozë është i ashtuquajtur chemoterapia. Shërimi është efektiv, në qoftë se vetvetiu ju përmbahesh udhëzimeve dhe bashkëpunon me personelin shërues.

### Barnat

Nga tuberkuloza mund të shërohesh vetëm me anë të mjekimit me barna për një kohë të gjatë. Barnat shëruese në Finlandë në përgjithësi përdoren 9-12 muaj. Me marrjen e



# TERVEYSÄVAIN

## Sämundjet ngjitëse

### TUBERKULOZA, vazhdon...

këtyre barnave për 1-2 javë nuk mund të shërohesh, edhe pse ndoshta më herët me antibiotik ja keni dalë të shëroheni. Të gjitha llojet e tuberkulozëve shërohen në mënyrë të njëjtë, d.m.th., me mjekim me barna për një kohë të gjatë.

### Pengesat apo kundër efektet e barit shërues

Në kohën e some barnat për tuberkulozë shkaktojnë relativisht pak pengesa, në dyshim se ke çrregullime lajmëro personelin shërues që të kontrollojnë. Përdorimi i barnave për tuberkulozë dhe përdorimi i barnave tjera në të njëjtën kohë duhet të merret parasysh. Për atë arsye është me rëndësi, që mjeku të dijë për të gjitha barnat (barnat për sëmundjen e sheqerit, barnat për preventim të ngjizjes së gjakut, e-hapat etj.).

### Përdorimi i barnave

Vetëm barnat mund t'i zhdukin bacilet tuberkulozes. Tuberkulozi shërohet plotësisht, nëse merrni barnat simbas udhëzimeve të dhëna për ato. Mos ndërro apo nderpre barin shërues simbas mendimit tënd.

Efkti i barit shërues zakonisht mbrenda dy apo tri jave largon rrezikun e infektimit. Edhe për këtë arsye marrja e barnave me rregull është shumë me rëndësi.

### Duhani dhe alkoholi

Duhani është gjithmonë i rrezikshëm, mirëpo shumë më i rrezikshëm është atëherë kur mushkërit janë të sëmuara. Gjatë kohës së marrjes së barit shërues ikë përdorimit të alkoholit.

---

Barnat merrni rregullisht një herë në ditë, në atë kohë kur juve ju përshtatet më së miri! Mësojeni përmendësh emrat e barnave të cilat i përdoreni! Shkoni në kontrollime të vazhdueshme të caktuara! Në rast se keni vështësi kontaktoni vendin ku jeni duke u shëruar!

Për përmbajtje shpërblehesh - tuberkuloza shërohet përgjithmonë.

---

# TERVEYSVAIN

## Mostrat e urinës dhe jashtëqitjes

### MOSTRAT E URINËS

#### Meshkujt

Mos urino se paku kater orë para dhënjes se urinës për analiza. Së pari pastroni duart. Pastaj pastroje mirë kokën e penisit. Lëshoje se pari pak urinë në zgavren e WC-së, ndërkohë mbushe epruveten e dhënur për mostra, dhe ne fund prap në zgavër të WC-së. Për rezultate informohesh sipas udhë zimeve të mjekut.

#### Femrat

Mos urino së paku katër orë para dhënjes së urinës për analiza. Së pari pastroni duart. Pastaj organet gjenitale të femrave. Lëshoje se pari pak urinë në zgavër të WC-së. ndërkohë ne epruveten e dhënur për mostra , dhe në fund prap në zgavër të WC-së. Për rezultate informohesh sipas udhëzimeve të mjekut.

### MOSTRAT E JASHTËQITJES

- Jashtëqitjen e kryeni ne enën prej kartoni në të cilen është shtruar letër e WC-së.
  - Me lugen që është në kapakun e epruvetës, merr 3-4 lugë nga jashtëqitja dhe vendos në epruvetë.
  - Jashtëqitjen e marrun perzije në epruvet me 10 % e materjes se formalinit qe gjendet ne epruvetë.
  - Shikoni se në epruvetë se është emri i yt dhe data e sakt.
  - Mbylle epruveten me kapak dhe vendose atë në qese plastike.
  - Hidhe jashtëqitjen dhe letren e mbetur në zgavër WC-së dhe enën prej kartoni hudhe në mbeturina.
  - Pastroni duart me kujdes.
  - Mostrat e marra për analiza dergoni në laboratorium \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- Për rezultate informohesh sipas udhëzimeve të mjekut.

Epruveta për mostra duhet të ruhet prej fëmijëve sepse materja e formalinit që gjindet në të është helmuese.


# TERVEYSVAIN

## Pëdorimi i prezervativit (kondomit)

Prezervativ mund të bleni nëpër shitore, kiosqe, barnatore, stacione të benzines etj. Në Finlandë janë në shitje prezervativ të llojeve me paketime të ndryshme.

Shiko në paketim datën e fundit të përdorimit së prezervativit. Mos i përdor prezervativet e vjetërsuar. Prezervativin mundë ta përdorni vetëm njëherë. Prezervativët e vjetërsuar apo të përdorur nuk ju mbrojnë nga sëmundjet venerike e as nga shtatëzania. Prezervativi duhet përdoret gjatë tër kohës së mardhënjes seksuale.

1. Hape me kujdes prezervativin e paketur, që të mos shkyhet prezervativi. Kape majen e prezervativit, largoje ajrin nga ai dhe mbështille penisin me prezervativ. Prezervativin vendose me dy duart.
2. Penisi mbështillet me prezervativ deri në fund. Maja e prezervativit duhet të lihet e zbrazët për spermë.
3. Pas masturbimit nxirre penisin menjëherë në të njëjtën kohë mbajeni prezervativin me dorë, me qëllim që të mos heqet ai para kohe.
4. Prezervativin e përdorur lidhe nyje dhe hudhe në shportën për mbeturina. Atë nuk guxon ta hedhësh në zgavren e WC-së, sepse prezervativi shumë lehtë mbyll kanalizin.



# TERVEYSVAIVAIN

## Vaksinat

### PSE VAKSOINOHEMI?

Me vaksionimin e fëmijës dhe familjes së tijë kanë dobi të gjithë, sepse me atë pengohet përhapja e epidemive në popull. Vaksionimi është mënyra më e mirë me të cilën mund të zhduken plotësisht sëmundjet nga globi i tokës. Në këtë mënyrë është zhdukë lija.

### QKA ËSHTË VAKSIONIMI?

Vaksionimi në princip është i thjeshtë dhe i natyrshëm. Me vaksionim organizmi vjen në kontakt me të njëjtit shkakëtar të sëmundjes sikurse në sëmundjet ngjitëse mirëpo në formë të parrezikshme. Vaksina mbron organizmin e njeriut duke u bazuar në atë që ai vet krijon imunitet ndaj epidemis.

### VAKSINAT MIRREN VULLNETARISHT

Të gjitha vaksinat që jipen në Finlandë nëpër klinika mirren pa pagesë dhe vullnetarisht.

### PSE ËSHTË I NEVOJSHËM VAKSIONIMI?

Në Finlandë higjiena është në nivel dhe të sëmuarit serioz dergohen menjëherë te mjeku. Finlanda dhe të huajt që banojnë këtu janë në kontakte të përherëshme me njerëzit që banojnë në vende tjera. Udhëtimet jashtë shtetit dhe musafirët e familjes shtojnë mundësin e infektimit. Fëmiju dhe i rrituri i pavaksionuar mund të sëmuret me epidemi infektuese, kundër të cilës nuk kanë materje mbrojtëse.

### KUR NUK BËHET VAKSIONIMI?

Nëse fëmija ka temperaturë vaksionimi shtyhet, përderisa t'i kaloj temperatura. Kollitja, shkuarja e hundës apo përdorimi i barnave nuk janë pengesë për vaksionim. Në qoftë se personi është tejet i ndieshëm në ndonjë materje të vaksines, ai nuk vaksionohet. Në imunitetin tejet të dobësuar (si psh. leukemia) mundë është pengesë për vaksionim. Për këto çështje bisedo përpara me mjekun ose infermierin.

# TERVEYSÄVAIN

## Vaksinat

### ME VAKSINAT KLINIKAVE SHËNDETËSORE EVITOHEN 10 SËMUNDJE

#### 1. Tuberkuloza

Në Finlandë tuberkuloza është ende deri në atë masë, që mund të infektohet si fëmija ashtu edhe i rrituri. Tuberkuloza zhvillohet ngadal dhe mund të dëmtoj organe të shumta në organizëm. Forma e përgjithëshme e manifestimit të asaj është tuberkuloza në mushkëri. BCG-vaksina Calmet mbron nga tuberkuloza.

#### 2. Kolla e bardhë (pertussis)

Është sëmundje e organeve të frymëmarrjes. Kjo ka manifestimet e veta të shpeshta të përcillura me vjellje dhe perfundojnë me shpërthim kollitjesh. Fëmijëve të vegjel kolli i bardhë është shumë i rezikshëm. Mjekim të kësaj sëmundje nuk ka. PDT-apo vaksina e trefisht mbron fëmijët nga kolla e bardhë deri në moshën e shkollore.

#### 3. Difteria

Është sëmundje që manifestohet me temperaturë dhe shkakëton ndezjen e fytit. PDT- vaksina mbron nga difteria.

#### 4. Sharrëza, Tetanoza (Tetanus)

Njeriu infektohet me këtë epidemi, në qoftë se bakteret të cilat gjenden në tokë depërtojnë në organizëm si për shembull nëpërmes plagës. PDT-vaksina mbron nga sharrëza, (tetanoza).

#### 5. Polio (Poliomyelitis), paraliza fëmijëve

është një sëmundje infektuese e zakonshme në vendet e zhvilluara. Në Finlandë kemi arritur të zhdukim me ndihmen e vaksines. Polio vaksina mbron me sukses nga epidemia.

#### 6. Sëmundja hemofilit

Hemofilus (Hib) bakteret shkakëtojnë sëmundje serioze infektuese: helmim, infeksion membranës së trurit, infeksion të grykës së fytit dhe kallje të mushkërive. Hib-vaksina mbron nga sëmundja e hemofilit.

#### 7. Fruthi (morbilli)

ngjitet shumë lehtë. Në vazhdim fruthi shkakëton edhe sëmundje të tjera, sikur kallje të mushkërive dhe infeksion në membranën e trurit. MPR-vaksina mbron nga fruthi.

#### 8. Shytat (parotytis)

Në përgjithësi është sëmundje e virusit të lehtë. Te meshkujt kjo sëmundje mund të paraqitet me infeksion në testise, mund të shkakëtoj atë që mashkulli nuk mund të bëhet babë. Virusi i sëmundjes së shytes mundë të shkakëtoj gjithëashtu edhe inflamacion të trurit apo membranës së trurit. MPR-vaksina mbron nga sëmundja e shytes.

#### 9. Rubeola (rubella)

është sëmundje e lehtë e shkakëtuar nga virusi. Rubeola në kohën e shtatëzanis, mundë shkakëtoj dëme edhe foshnjës ende të palindur. MPR-vaksina mbron nga rubeola.

#### 10. Hepatiti B (HBV)

mund të shkakëton inflamacion të mëlçis apo sëmundjen e vërdhezës. Menjëherë pas ekspozimit të virusit të hepatitit B vaksina dhe antitruapat e dhënë mundë ta evitojn infektimin. Mjekim për përmirësim nuk ka.

# TERVEYSÄVAIN

## Vaksinat

### PROGRAMI I VAKSIONIMIT TË FËMIJËVE

Fëmiju i posalindur është i mbrojtur mirë kundër sëmundjeve infektuese. Ai, gjatë kohës së shtatëzënis nga nëna ka marrë antitropa. Ato mbrojnë së bashku si qumështin e gjirit edhe fëmijën nga ato sëmundje që nëna vetë është immune. Imuniteti i fëmijës i marrur nga nëna mund të zgjatë disa muaj.

Vaksinimi fillon menjëherë kur organizmi i fëmijut është i gatshëm të formoj antitropa. Mbrojtja më e mirë kundër sëmundjeve ngjitëse mirret, në qoftë se programi i vaksinimit së klinikës respektohet dhe i kushtohet kujdes i veçantë.

### PROGRAMI I VAKSIONIMIT TË FËMIJËVE

<u>Mosha e fëmijës</u>	<u>Vaksina</u>
<u>&lt; 1 javë</u>	<u>BCG</u>
<u>3 muaj</u>	<u>PDT I</u>
<u>4 muaj</u>	<u>PDT II dhe Hib I</u>
<u>5 muaj</u>	<u>PDT III</u>
<u>6 muaj</u>	<u>Polio I dhe Hib II</u>
<u>12 muaj</u>	<u>Polio II</u>
<u>14-18 muaj</u>	<u>MPR I dhe Hib III</u>
<u>20-24 muaj</u>	<u>PDT IV dhe Polio III</u>
<u>6 vjet</u>	<u>MPR II dhe Polio IV</u>
<u>0,1.6 muaj</u>	<u>HBV *</u>

\* fëmijës të posalindur, të nënes bartëse e virusit hepatitit B.

# TERVEYSVAIN

## Vaksinat

### VAKSINA BCG E FEMIJUT

Fëmiju ka marrë BCG vaksinen, e cila e mbron atë nga tuberkuloza. Reaksionet në këtë vaksinë janë sa vijon: 2-3 javë pas marrjes së vaksines në vendin ku është marrë vakcina forcohet. Më vonë ngadal ndryshon në fluskë të lagësht. Fluska e lagët duhet te mbulohet me fasho të terur .

Përafërsisht pas katër jave fluska e lagët zakonisht ndryshon në formë kore, e cila heqet 5-6 javë pas vaksionimit. Në atë vend mbetet plagë me madhësi 5-10 milimetra, e cila shërohet mbrenda 10-13 javëve. Nga kjo vaksinë do mbetet një shenjë e bardhë dhe e rrumbullakët. Në qoftë se reaksionet nga kjo vaksinë zgjatën me tepër se normalisht apo fëmijës i manifestohen simptome tjera, kontakto infermierin e këshilltores.

# TERVEYSVAIN

## Vaksinat

### POLIO VAKSINA

Polio vakcina ju mbron kundër sëmundjes së ashtuquajtur poliomyelitis. Pa këtë vaksinë egziston mundësia të paraqiten paraliza të ndryshme. Në Finlandë fëmijët dhe të rriturit i vaksionojm kundër sëmundjes së polios dhe në këtë mënyrë ne kemi zhdukë këtë sëmundje nga shteti ynë.

### TETANOZ VAKSINA

Tetanoz d vakcina jep mbrojtje kundër dy sëmundjeve, të cilat janë tetanoza dhe difteria.

Simbas programit të përgjithshëm Finlandez për vaksionim, fëmijët e moshës së shkollorë vaksionojmë në organizatën shëndetësore të shkollës, dhe fëmijët nën moshën shkollorë vaksionojm në kshillimorën e fëmijëve.

Programi i vaksionimit për të rritur sa vijon:

Polio I	
Td	menjëherë
Polio II	
TD	pas dy muajve
Polio III	
Td	pas një viti

Eshhtë me rëndësi, që t'i merrni të tri vaksinat për shkakë të mbrojtjes së mjaftueshme. Të dyjat së bashku kanë efekt 10 vjet.

**Këto vakcina merren vullnetarisht dhe janë pa pagesë.**



# TERVEYSVAIVAIN

## Të drejtat e pacientit

Ligji për të drejtat dhe statusin e pacientit përmirëson të drejtën e sigurimit të pacientit dhe lehtëson bashkëpunimin me puntorët shëndetësor. Në mardhënje me ligjin hyjnë të gjitha shërbimet shëndetësore të cilat i ofrojnë entet sociale dhe të shëndetit.

Në praktikë domethën sa vijon:

- Pacienti vet pajtohet për shërim.
- pacientit i sqarohet se si është gjendja e tij shëndetësore, gjithë se çka ndërmirret për shërimin e tij, çfarë mund të është rreziku dhe mënyrat e mundëshme tjera të shërimit.
- Pacienti i cili është në radhë për shërim, e është i detyruar të pres ai duhet të njoftohet për shkakun e pritjes dhe përafërsisht kohën se sa duhet të pres.
- Pacienti i cili është i pakënaqur me shërim, mundë të ankohet në institutin shëndetësor.
- Në institutet shëndetësore gjinden ndihmës të autorizuar për pacient.

Gjithë banorët që jetojnë në Finlandë, për gjendjen e tyre shëndetësore kanë të drejtë për shërim dhe sigurim shëndetësor në të gjitha suazat dhe në kufijt e kapaciteteve të cilat janë në disponim.

Pacienti ka të drejtë për shërim të plotë dhe respekt. Shërimi duhet të është i organizuar në atë mënyrë, që mos të ofendohet intimiteti, serioziteti apo nderi i pacientit. Sipas mundësive, merret parasysh gjithëashu edhe gjuha amëtare, kultura dhe personaliteti i pacientit. Kur në pyetje është fëmija, duhet merret parasysh edhe nevoja për antarët tjerë të familjes.

### PAJTIMI DHE MIRËKUPTIMI

Me ligjin e ri nukë zvoglohet përgjegjësia e punëtorve medicinal në lidhje me zgjedhjen e mënyres së shërimit. Para se gjithash, vendimi dhe mënyra e shërimit duhet të bëhet me pëlqimin dhe në mirëkuptim me pacientin. Në qoftë se Pacienti refuzon ndonjë shërim apo intervenim mjekësor, atëherë duhet të kërkohet ndonjë metodë tjetër e shërimit.

Kurë është fjala për intervenime të vogla, me lajmërimin vet pacientit për ndihmë konkludohet si pajtim i tij për shërim. Mirëpo sipas rregullave, gjithëashu në bisedë me pacientin duhet të sqarohet edhe pyetja në lidhje me pajtimin për shërim. Për atë arsye është me rëndësi, që pacientit ti spjegohet se si është gjendja e tij shëndetësore, gjithë se çka ndërmirret për shërim, rreziku i mundshëm dhe cilat janë mënyrat e mundëshme të shërimit.

Ligji i obligon puntorët shëndetësor, që prej fillimit të dhënjes së ndihmës së parë edhe gjatë shërimit t'i japin pacientit informime të mjaftueshme dhe të karta për gjendjen.

Në qoftëse Pacienti dhe personeli nuk kanë një gjuhë të përbashkët, duhet të thirret përkthyesi. Përkthyesi duhet edhe në rastin kur bisedohet me pacient me të meta në të folur dhe në ndëgjim.

Personeli mjekësor, është i kujdesëshëm që çështjet në lidhje me shërimin dhe të dhënat mbi pacientin, të dhënat nuk japin personave të huaj pa lejen e pacientit.

Ndihma e domosdoshme mjekësore ipet edhe pa pëlqim, atëherë kur Pacienti është pavetëdije dhe gjendja e tij është në rrezik për jetë ose shëndet.

Sosiaal- ja terveystoimintöiden esittöitä 1993:2 / ohje (19) Käännös: Tulkkiokeskus Lingua Nordica

Potilaan oikeudet/albania/saa kopioida

# TERVEYSÄVAIN

## Të drejtat e pacientit

Në qoftë se dihet, se çfarë ka qenë dëshira e pacientit në lidhje me shërim para ramjes në komë, punohet sipas asaj.

Në qoftë se pacienti nuk mund të vendos për shërimin e tij për shkaqe, si për shembull me të meta mentale ose plogështis në pleqëri, para marrjes së vendimit të rëndësishëm për shërim, personeli mjekësor kërkon nga të afërmit e pacientit për mendimin e tyre për shërim.

### SHËRIMI I TË MITURVE

Kur fëmija si pacient shërohet, parasysh merret mendimi i tij. Në disa raste i riu mund të është mjaft i pjekur që ai të vendos për shërimin e vetë. Në atë rast i riu ka të drejtë të ndalojë që të dhënat e tij mbi shërimin dhe gjendjen shëndetësore të mos ipen prindërve dhe të afërmeve tjerë. Për pjekurin e personit të ri në këto raste përgjegjës janë mjekët ose profesionistët tjerë.

Ligji mbron pacientet e mitur ashtu që prindët nuk kanë të drejtë ta refuzojnë dhënjen e ndihmes, me të cilën ndihmë shpëtohet jeta e të miturit ose iket nga rreziku që mund të çfaqet në gjendjen e tij shëndetësore.

### PRITJA PËR SHËRIM

Në qoftë se pacienti përkohësisht apo nuk pranohet për shërim, atij duhet t'i sqarohet shkak. Në qoftë se pacienti ka ardhur në vend të gabuar për shërim, ai udhëzohet që të shkojë në vendin e duhur. Pacienti i cili është i detyruar të pres për shërim duhet të lajmohet se sa do zgjatë pritja.

### SHËNIMET MBI PACIENTIN

Pacienti ka të drejtë të shikoj se çka është shkruar në kartonin e tij shëndetësor, dhe sipas nevojë ta përmirësojë ato.

Të dhënat e shënuara në kartonin shëndetësor të pacientit mbahen sekrete. Personeli mjekësor këto të dhëna nuk guxon t'i japë të huajve pa autorizim me shkrim nga pacienti. Për të huaj konsiderohen të gjithë ata përveç personelit mjekësor në repart të cilët janë të angazhuar në shërim të pacientit.

Të afërmit e pacientit, si të afërmit dhe anëtarët tjerë të familjes në këtë rast konsiderohen si të huaj.

Në rast se pacienti nuk mundet të vendos për shërim, të afërmeve apo anëtarve të familjes u ipen informata të nevojshme për të gjetur zgjedhjen më të dëshirueshme për shërim të pacientit. Në rast se pacienti në gjendje të pavetëdijëshme është marrë për shërim, për këtë duhet të informohet më i afërmi i familjes së tij, anëtar i familjes apo ndonjë person i afërt, në qoftë se nuk ka dyshim se pacienti nuk do të është kundër asaj.

Në raste të rralla të jashtëzakonshme e drejta e pacientit për të kërkuar shënime të veta nga kartoni shëndetësor mund të është e kufizuar, në qoftë se konkludohet se ajo mund të shpijë rrezik serioz për jetë dhe shëndet të pacientit.

# TERVEYSAVAIN

## Të drejtat e pacientit

### JURISTI PËR PACIENT

Juristi për pacient këshillon pacientin për të drejtat e tij dhe ndihmon atë të përshkruaj ankesë, ngrit akuzë apo kërkes për kompensim në të holla. Në qoftë se pacienti nuk është i kënaqur me shërim apo sjelljes ndaj tij, ai mund të ankohet në drejtorin e repartit. Pacienti ka rast që me shkresë në mënyrë të thjeshtë ta shprehë mendimin për personel të repartit. Në të njëjtën kohë, duke u bazuar në shkresë, reparti do të ket mundësi që shpejt të përmirësoj gabimin.

Nëse gjatë shqyrtimit të vërejtjes vjen, si p.sh. deri te ndonjë gjobë me të holla apo padisciplin nga pacienti, juristi i pacientit ndihmon pacientin që çështja të shtyhet për shqyrtim të mëtutjeshëm. Dhënja e vërejtjes me shkrim, nuk kufizon të drejten e pacientit për formimin e ankeses për shërim të dobët apo sjellje ndaj tij, ndaj organeve kompetente shëndetësore të cilat janë përgjegjëse për shërim.

- 1993: 1 Perhetukitoimikunnan välimietintö.  
2 Yksinhuoltajat ja elatusvelvolliset - taloudellinen asema ja tukivaihtoehdot.  
3 Päivi Hakola. Auta äitiä, suojele tytärtä! Naisten ympärileikkaus - uusi terveyskasvatuksellinen haaste Suomessa.  
4 Markku Pekurinen. Kilpailun esteitä Suomen terveydenhuollossa.  
5 Euroopan neuvosto. Vammaispoliittinen kokonaisuohjelma. Pariisi, marraskuu 1991.  
6 Pakolaisten ja turvapaikanhakijoiden infektio-ongelmien ehkäisy.  
7 Kertomus romaniasiain neuvottelukunnan toiminnasta 1990-1992.  
8 Veteraanikuntoutuksen suuntaviivat 1990-luvulle. 1.-2.12. 1992 Peurungan kuntoutumis- ja liikuntakeskuksessa pidetyn seminaarin alustukset.  
9 Arto Koho. Sosiaaliturva ja aikuiskoulutus.  
10 Kustannukset. Pakolaisten ja turvapaikanhakijoiden vastaanoton kustannusten korvaaminen.  
11 Perhetukitoimikunnan mietintö. Lapsikorotusjärjestelmien vaihtoehdot.  
12 Pirjo Marjamäki. Sosiaali- ja terveydenhuollon asiakasmaksut kunnissa.  
13 Rakennusalan työterveyshuoltojaoksen muistio.  
14 Terhikki Mäkelä. Pakolaisperheiden ja päivähoidon kohtaaminen.  
15 Turvapaikanhakijoiden toimeentulotuki. Pakolaistoimiston ohjeita ja sovellutuksia vastaanottoasemien ja -keskusten työntekijöille.  
16 Sosiaali- ja terveysministeriön julkaisut vuonna 1992.  
17 Sosiaali- ja terveysministeriön taloussääntö 1.6.1993.  
18 Yhteenveto sosiaali- ja terveydenhuollon kertomuksesta 1992 : koko maa.  
19 Veteraaniprojekti 1992.  
20 Anne Kauhanen-Simanainen. Sosiaali- ja terveysministeriön hallinnonalan kirjastot ja tietopalvelut muutostilanteessa - mahdollisuudet ja uhat.  
21 Maatalousyrittäjien lomituspalvelut. Tilastoja vuodelta 1992.  
22 Terveysseuranasto. Terveysavain - Hälsönyckel suomi - ruotsi.  
23 Terveysseuranasto. Terveysavain englantia.  
24 Terveysseuranasto. Terveysavain venäjä.  
25 Terveysseuranasto. Terveysavain serbokroatia.  
26 Terveysseuranasto. Terveysavain vietnam.  
27 Terveysseuranasto. Terveysavain arabia.  
28 Terveysseuranasto. Terveysavain somali.  
29 Terveysseuranasto. Terveysavain ranska.  
30 Terveysseuranasto. Terveysavain persia.  
31 Vammaisneuvosto ja vaikuttaminen. Seminaariraportti.  
32 Terveysseuranasto. Terveysavain albania.